



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 793 / prot.
2

Tiranë më 13. 7. 2018

VENDIM

Nr. 34, datë 13. 2. 2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETI T PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Gazeta “Shëndet Plus”, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankesën nr. 793 Prot., datë 27.04.2018, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Inspektorati Shtetëror Shëndetësor” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën e datës 21.03.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion informacioni i mëposhtëm:

1. Në sa klinika dhe spitale private janë kryer inspektime për vitin 2016?
2. Në sa klinika dhe spitale private janë kryer inspektime për vitin 2017?
3. Në cilat (emrat) klinika dhe spitale private janë kryer inspektime për vitin 2016?
4. Në cilat (emrat) klinika dhe spitale private janë kryer inspektime për vitin 2017?
5. Sa është numri i klinikave dhe spitaleve private ndaj të cilave keni marrë masa për shkelje të konstatuara gjatë inspektimit? A keni kërkuar mbyllje të klinikave apo spitaleve private për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit? Nëse po, cilat janë ato?
6. Cilat janë spitalet private të licencuara për kryerjen e aborteve?
7. Cilat janë klinikat private të licencuara për kryerjen e aborteve?
8. A janë kryer ndonjëherë inspektime pranë këtyre spitaleve dhe klinikave private lidhur me abortet?

9. *A janë konstatuar shkelje të ligjit në spitalet dhe klinikat private?*
10. *A janë konstatuar raste të kryerjes së aborteve pas javës së 12 të shtatzënisë?*
11. *Sa është numri i spitaleve apo klinikave private ndaj të cilave keni marrë masa për shkak të shkeljes së ligjit, domethënë, që kanë kryer aborte pa qenë të licencuara për t'i kryer ato, si dhe që kanë kryer aborte pas javës së 12 të shtatzënisë?*

Pas përfundimit të afatit të caktuar me ligj për vënien në dispozicion të informacionit publik të kërkuar, ankuesi nuk ka marrë përgjigje nga Autoriteti Publik lidhur me informacionin e kërkuar.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me urdhrin nr. 141 Prot., datë 09.05.2017, ushtroi inspektim pranë Autoritetit Publik, dhe nga verifikimet e kryera rezultoi se kërkesa nuk ishte trajtuar për arsye të mungesës së kriterëve formale të saj, si adresa e kërkuarit, vula, logo etj. Pas sqarimit të arsyeve që ishin bërë pengesë deri në atë moment për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, me shkresën nr. 536/2 datë 10.05.2018, Autoriteti Publik i ktheu përgjigje ankuesit, të plotësuar në vijim me e-mail të datës 24.05.2018, por që në vlerësimin e këtij të fundit (ankuesit) përgjigja vijonte të mbetej e paplotë dhe jo gjithëpërfshirëse në raport me kërkesat e tij.

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv si dhe në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin shprehimisht thuhet se "...me marrjen e ankesës, Komisioneri Për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale...kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", Komisioneri me shkresën nr. 793/5 Prot., datë 04.06.2018, ftoi palët në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me praninë e përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit nga njëra anë dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik nga ana tjetër.

Në lidhje me informacionin e vënë në dispozicion të ankuesit përfaqësuesit e Autoritetit Publik i qëndruan argumenteve të paraqitura në aktet shkresore të trajtuara më sipër, argumente të cilat i rikonfirmuan dhe me e-mailin e datës 11.06.2018, dërguar ankuesit pas seancës dëgjimore. Më konkretisht Autoriteti Publik pretendon se:

"Lidhur me pikat 1 dhe 2 të kërkesës se në sa klinika dhe spitale private janë kryer inspektime për vitin 2016 dhe vitin 2017, është kthyer përgjigje për numrin e përgjithshëm të inspektimeve të kryera.

1- Lidhur me pikën 3 dhe 4 të kërkesën, në cilat (emrat) klinika dhe spitale private janë kryer inspektime për vitin 2016 dhe 2017, Autoriteti publik ka argumentuar refuzimin bazuar në Ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" si dhe Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", informacioni i kërkuar në këto pika nuk mund të publikohet për shkak të mbrojtjes së interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë. Gjithashtu mbështetur dhe në Kodin e procedurave administrative nr. 44/2015, në nenin 1 parashikohet se ky Kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave fizikë

dhe juridikë si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre në realizimin e këtyre funksioneve duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor.

2- Lidhur me pikën 5 të kërkesës, sa është numri i klinikave dhe spitaleve private për të cilat janë marrë masa për shkelje të konstatuara gjatë inspektimit dhe cilat janë masat e marra, Autoriteti publik ka kthyer përgjigje për numrin e përgjithshëm të masave administrative të marra për vitin 2016 dhe vitin 2017. Përsa i përket identifikimit me emra konkretë, Autoriteti argumenton refuzimin bazuar në Ligjin 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe nenin 15 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi procedurave administrative", sipas së cilit "Organet publike dhe nëpunësit e tyre kur kryejnë një procedurë administrative mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve në përputhje me legjislacionin në fuqi".

3- Lidhur me pikat 6 dhe 7 të kërkesës, cilat janë spitalet private dhe klinikat e licencuara për kryerjen e aborteve, Autoriteti ka sqaruar se nuk ka kompetenca për përleshimin e licencave për subjektet që ofrojnë shërbim shëndetësor në zbatim të Ligjit nr. 8045 datë 07.12.1995 "Për ndërprerjen e shtatzënisë", dhe për këtë arsye kërkesja mund ti drejtohej institucionit i cili procedon me lëshimin e licencave. Dhënia e këtij informacioni nga ISHSH do të ishte tejkalim kompetencash.

4- Lidhur me pikën 8,9, 10, 11 të kërkesës, nëse janë kryer ndonjëherë inspektime, a janë konstatuar shkelje, raste të aborteve pas javës së 12 të shtatzënisë dhe sa është numri i klinikave apo spitaleve private ndaj të cilave janë marrë masa Autoriteti ka informuar kërkuuesen se, inspektimi i kryer pranë spitaleve apo klinikave bëhet sipas programeve vjetore të inspektimit të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Inspektorati Qendror në zbatim të të gjithë kuadrit ligjor të posaçëm të Autoriteti ku bën pjesë dhe Ligji nr. 8045 datë 07.12.1995 "Për ndërprerjen e shtatzënisë", i ndryshuar.

Në përfundim, Autoriteti Publik citon nenin 4 të Kodit të etikës për punonjësit e Inspektorateve Shtetërore në Republikën e Shqipërisë, "Ruajtja e informacionit dhe komunikimi me publikun", si argument për mospublikimin e informacionit."

Komisioneri vlerëson se arsyetimi i bërë nga Autoriteti Publik për refuzimin e kërkesave vjen si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit nga ana e tij lidhur me atë çka lejohet të bëhet publike ose jo.

Sa i përket pikave 1 dhe 2 të kërkesës, Autoriteti Publik jep informacion lidhur me numrin e përgjithshëm të subjekteve të shërbimit shëndetësor spitalor dhe ambulator që i janë nënshtruar inspektimit për vitet e kërkuara (konkretisht 2016-2017), duke mos saktësuar sa prej këtyre subjekteve kanë qenë private, çka përbën dhe objektin e kërkesës së ankuesit. Komisioneri vlerëson se këto janë të dhëna statistikore që zotërohen nga Autoriteti Publik, ose janë lehtësisht të identifikueshme prej këtij të fundit, dhe nisur nga karakteri sensitiv që paraqet sektori i shëndetësisë, Autoriteti Publik ka detyrimin t'i bëjë ato publike.

Sa i përket informacionit të kërkuar në pikat 3 dhe 4 të kërkesës për informacion, ku kërkohen emrat e klinikave dhe spitaleve private të cilat i janë nënshtruar inspektimit për vitet 2016-2017, Autoriteti Publik pretendon se dhënia e informacionit vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale",

i ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative. Sipas Autoritetit Publik, veprimtaria e inspektimit ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë.

Komisioneri vlerëson se ky arsyetim i Autoritetit Publik është i gabuar pasi informacioni i kërkuar lidhet me të dhënat identifikuese të klinikave dhe spitaleve private të cilat, për nga forma e organizimit janë subjekte tregtare, dhe nuk klasifikohen si të dhëna personale në kuptim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Në bazë të nenit 3, pika 1 e ligjit të sipërcituar, parashikohet se: "*E dhënë personale*" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social".

Gjithashtu Komisioneri vlerëson se kërkesa lidhet ngushtë me veprimtarinë institucionale të Autoritetit Publik dhe është e drejtë e publikut në tërësi që të informohet lidhur me veprimtarinë që ushtron ky i fundit, si një institucion shtetëror që i shërben ofrimit të shërbimit shëndetësor në përputhje me standardet ligjore. Bazuar në pikën 2/II, dhe në pikën 5/a, b, ç, dh/III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 27.3.2013, "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor", Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është përgjegjës për të ushtruar funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, (me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike), dhe ky institucion, në nivel qendror ka ndër të tjera si pjesë të detyrave të tij "*...të informojë publikun për veprimtarinë e inspektimit dhe përgatitë programin dhe raportin vjetor të inspektimit*" (dokumente këto që në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" përmbushin kriteret për t'u konsideruar si informacion publik).

Mbrojtja e interesit publik të cilin veprimtaria e Autoritetit Publik ka për qëllim, realizohet pikërisht duke promovuar transparencën dhe duke i lejuar publikut të informohet mbi standardet e ofruara nga strukturat shëndetësore. Kjo transparencë nuk do të cënonte interesat e ligjshëm të subjekteve që i janë nënshtruar veprimtarisë inspektuese, pasi legjislatori iu ka vënë në dispozicion instrumente ligjorë për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Do të ishte në kundërshtim me frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit të zbatueshëm nëse të drejtat e personave juridikë e fizikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e shërbimeve spitalore dhe ambulatorie, do të mbroheshin duke kufizuar të drejtat kushtetuese të publikut për t'u njohur me veprimtarinë e organeve publike.

Sa i përket informacionit të kërkuar në pikën 5 të kërkesës, Autoriteti Publik refuzon vënien në dispozicion të kërkuarit të të dhënave lidhur me: "*numrin e klinikave dhe/ose spitaleve private ndaj të cilave janë marrë masa për shkelje të konstatuara gjatë inspektimit, nëse është kërkuar mbyllje e klinikave apo spitaleve private për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit, dhe emrat e tyre, nëse ka të tilla*", me arsyen se një veprim i tillë do të vinte në kundërshtim me Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative, pasi sipas Autoritetit Publik kjo do të cënonte interesat e ligjshme të personave fizikë dhe juridikë subjekt inspektimi dhe procesin e rregullt ligjor.

Komisioneri e gjen këtë arsytim në interpretim të gabuar të ligjit. Siç e kemi arsyetuar edhe më lart, klinikat dhe spitalet private janë subjekte tregtare, dhe si të tillë emrat e tyre nuk mund të klasifikohen si të dhëna personale në kuptim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Gjithashtu, informimi i publikut me këto të dhëna nuk do të shkaktonte asnjë dëm për interesat e ligjshëm të subjekteve të përfshira në veprimtarinë inspektuese, të cilët, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor kanë të drejtë të ushtrojnë instrumentet ligjore që ligji iu ka vënë në dispozicion për të kundërshtuar masat administrative, nëse i gjejnë ato të pabazuara.

Sa i përket informacionit të kërkuar në pikat 6 dhe 7 të objektit të kërkesës, ku kërkohet se cilat janë spitalet private dhe klinikat private të licencuara për kryerjen e aborteve, Autoriteti Publik pretendon se do të vepronte në tejkalim kompetencash nëse do të jepte këtë informacion pasi nuk është institucioni i cili ka për kompetencë lëshimin e licencave për subjektet që ofrojnë shërbim shëndetësor në zbatim të Ligjit nr. 8045 datë 07.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”. Komisioneri vlerëson se ky qëndrim është i gabuar dhe vjen në kundërshtim me frymën e pikës 2 të nenit 12 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” nga ku rrjedh detyrimi për Autoritetin Publik për të vënë në dispozicion të kërkuarit informacionin nëse ai e disponon atë, edhe kur ky informacion nuk është prodhuar prej tij. Kjo dispozitë përcakton: *“Në rast se pas shqyrtimit të kërkesës Autoriteti Publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke vënë në dijeni edhe kërkuarin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës tek një autoritet tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.”*

Në lidhje me pikat 8, 9, 10 dhe 11 të objektit të kërkesës, Autoriteti Publik ka dhënë një përgjigje me karakter të përgjithshëm. Në këtë mënyrë ai nuk e ka përmbushur detyrimin për të informuar kërkuarin në përputhje me parimet e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga dokumentet shkresore të administruara gjatë procesit të hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionerit, (dhe më konkretisht: procesverbal i hetimit administrativ datë 09.05.2018, shkresë përgjigje e Autoritetit Publik nr. 536/2 Prot., datë 10.05.2018, Autorizim nr. 536/5 Prot., datë 07.06.2018, e-mail të datave 24.05.2018 dhe 11.06.2018) rezulton se nga ana e Autoritetit Publik ka pasur një refuzim të vazhdueshëm për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar. Posaçërisht, të gjithë personat e përfshirë në trajtimin e kësaj çështje, që nga titullari i Autoritetit Publik, inspektorët të cilët kanë nënshkruar procesverbalin e hetimit administrativ dhe kanë përfaqësuar Autoritetin Publik në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioneri, si dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit me e-maillet e datave 24.05.2018 dhe 11.06.2018, me veprimet dhe/ose mosveprimet e tyre, janë bërë në mënyrë të përsëritur pengesë për vënien në dispozicion të kërkuarit të informacionit të kërkuar.

Neni 18 i Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” përcakton se mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative. Pika 2, gërma a) e nenit të cituar më sipër përcakton se refuzimi i dhënies së informacionit sanksionohet me gjobë nga 150.000 deri në 300.000 lekë. Bazuar në pikën 3 të nenit 19 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përgjegjësia administrative sipas dispozitës së cituar më sipër bie mbi Koordinatorin për të Drejtën e Informimit.

Nga shqyrtimi i mësipërm rezulton se informacioni i kërkuar administrohet nga Autoriteti Publik duke përbushur në këtë mënyrë kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" sipas së cilës informacion publik konsiderohet "...çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Pra qartazi duket se kemi të bëjmë me kërkesë për dhënien e një informacioni publik nga autoriteti publik".

Gjithashtu, bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".

E drejta e informimit, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Organet e administratës publike janë të detyruara t'i nënshtrohen parashikimeve kushtetuese dhe të konventës, por dhe atyre të parashikuara në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", me qëllim garantimin efektiv të parimit të transparencës. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e llogaridhënies si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interes të të dy palëve.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon:

Neni 15 "1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhumueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre."

Neni 23 "E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore."

Në nenin 10 të KEDNJ është përcaktuar se: "Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë".

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e Gazetës "Shëndet Plus" ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit nr. 793 Prot., datë 27.04.2018 të Gazetës "Shëndet Plus", kundër Autoritetit Publik "Inspektorati Shtetëror Shëndetësor", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 21.03.2018, dhe konkretisht:
 1. Në sa klinika dhe spitale private janë kryer inspektime për vitin 2016?
 2. Në sa klinika dhe spitale private janë kryer inspektime për vitin 2017?
 3. Në cilat (emrat) klinika dhe spitale private janë kryer inspektime për vitin 2016?
 4. Në cilat (emrat) klinika dhe spitale private janë kryer inspektime për vitin 2017?
 5. Sa është numri i klinikave dhe spitaleve private ndaj të cilave keni marrë masa për shkelje të konstatuara gjatë inspektimit? A keni kërkuar mbyllje të klinikave apo spitaleve private për shkak të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit? Nëse po, cilat janë ato?
 6. Cilat janë spitale private të licencuara për kryerjen e aborteve?
 7. Cilat janë klinikat private të licencuara për kryerjen e aborteve?
 8. A janë kryer ndonjëherë inspektime pranë këtyre spitaleve dhe klinikave private lidhur me abortet?
 9. A janë konstatuar shkelje të ligjit në spitale dhe klinikat private?
 10. A janë konstatuar raste të kryerjes së aborteve pas javës së 12 të shtatzënisë?
 11. Sa është numri i spitaleve apo klinikave private ndaj të cilave keni marrë masa për shkak të shkeljes së ligjit, domethënë, që kanë kryer aborte pa qenë të licencuara për t'i kryer ato, si dhe që kanë kryer aborte pas javës së 12 të shtatzënisë? - brenda datës 20 . 7 .2018.
3. Dënimin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik, Znj. Anila Dedei, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjnë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
6. Ky vendim u shpall sot në datë 13 . 7 .2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

